

VENDIM
Nr. 546, datë 16.8.2012

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor 09120 “arsimi bazë” në shpenzime kapitale, të zbritet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

b) në programin buxhetor 09230 “arsimi i mesëm” në shpenzime kapitale, të shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha